

DEKLARATA E PARLAMENTIT TË PARË RURAL SHQIPTAR

MBAJTUR MË 28-30 SHTATOR 2017

Tiranë, Shqipëri



Miratuar në sesionin përmbyllës të Parlamentit të Parë Rural Shqiptar, mbajtur në sallën plenare të Kuvendit të Shqipërisë më 30 Shtator 2017

Hyrje

Mbi 300 pjesëmarrës ndoqën, kontribuan dhe miratuan Deklaratën e Parlamentit të Parë Rural Shqiptar. Pjesëmarrësit përfaqësojnë të gjithë aktorët dhe grupet e interesit të zhvillimit rural, fermerë dhe banorë të zonave rurale, organizata të ndryshme të shoqërisë civile, përfaqësues të autoriteteve vendore, rajonale dhe qendrore, agjenci zhvillimore dhe politikëbërës në nivele të larta, përfaqësues më në zë të akademisë dhe kërkimit shkencor nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, studentë, të rinj, komuniteti i donatorëve dhe përfaqësues të medias.

Puna për organizimin e Parlamentit kaloi përmes bashkëpunimit të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural me katër Agjencitë e Zhvillimit Rajonal për realizimin e shumë tryezave vendore me përfaqësues të bashkive, biznesit dhe shoqërisë civile. Për të arritur një pjesë të objektivave të Parlamentit Rural, në mënyrë të veçantë për ekspozimin e pjesëmarrësve ndaj praktikave të mira, një rol mjaft të rëndësishëm sollën edhe ekspertët e ftuar nga Italia, Sllovenia, Kroacia, Serbia, dhe Gjermania.

Konteksti Kombëtar

Popullsia në zonat rurale përbën 49% të popullsisë së përgjithshme të vendit dhe rreth 52% e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin bujqësor, i cili gjeneron 20% të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto. Niveli i varfërisë është 50% më i lartë në këto zona krahasuar me qendrat urbane. Bujqësia shqiptare ende vuan nga pasojat e dekollektivizimit të fillim viteve 1990. Një pjesë e mirë e tokave bujqësore po lihet pa punuar, ndërkohë që fragmentimi vazhdon të mbajë peng rritjen e konkurrueshmërisë në shumë zona të vendit. Pasiguria mbi tokën bujqësore dhe aksesit i ulët në kredi kufizon investimet e fermerëve në sektorin bujqësor. Në fushën sociale, 87% e grave në zonat rurale janë të punësuar në sektorin bujqësor dhe vetëm 7% e tyre janë sipërmarrëse, ndërsa perspektivat e punësimit për të rinjtë mbeten të ulëta.

Në shumë zona, komunitetet rurale vuajnë nga izolimi, aksesit i ulët në shërbime publike bazë dhe aksesit të kufizuar në tregje. Pak përpjekje të suksesshme janë bërë në zhvillimin e kapitalit social, marrëdhënive midis fermave dhe rrjetëzimit midis tyre në nivel vendor e kombëtar e përfshirja e ekonomisë jo-bujqësore ka qenë e penguar nga mungesa e një medisi tërheqës biznesi. Sektorin bujqësor i vetëjetesës është mbizotërues dhe diversiteti ekonomik është i ulët. Vetëm 22% e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjenden në zonat rurale. Mjedisi i biznesit është i prekur nga

zhvillimi i mpakur i tregjeve rurale, mundësitë e mangëta për punë të aftësuar, humbja e fuqisë punëtore për shkak të shpërnguljes së të rinjve dhe grave, tkurrja e shërbimeve, si dhe degradimi mjedisor.

Shoqëria civile haset gjithashtu me probleme zhvillimi. Pjesa më e madhe e saj është pak e përfshirë në periferitë rurale, pak e financuar dhe shpesh e ndikuar nga ngutshmëria e agjendave të donatorëve. Kërkimi shkencor nuk po gjen aksesin e duhur në vendim-marrje dhe nuk po i përgjigjet nevojave të larmishme lokale.

Reforma territoriale dhe Ligji i Vetëqeverisjes Vendore kërkon *a priori* vendosjen e një dinamike më të integruar midis territoreve urbane, suburbane dhe atyre rurale. Strategjitë në zonat rurale të bashkive mbeten akoma për t'u përcaktuar dhe zbatuar.

Vizioni i Përbashkët i Pjesëmarrësve të Parlamentit Parë Rural

Pjesëmarrësit në Parlamentin e Parë Rural Shqiptar ndanë vizionin për nevojën e forcimit të kohezionit social ekonomik të përbashkët dhe se qasja LEADER (akronim që në gjuhën frënge do të thotë: Lidhje midis Veprimeve për Zhvillimin Ekonomik Rural) përbën instrumentin më afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Qasja LEADER synon gjithashtu të fuqizojë zërin e komuniteteve rurale dhe grupeve më vulnerabël në këto zona, sikurse janë gratë dhe të rinjtë.

Ndërtimi i Grupeve Lokale të Veprimit (akronimi në anglisht LAG) si partneritet funksional midis sektorit publik dhe atij privat duke përfshirë shoqërinë civile mund të shndërrohet në promotor të pazëvendësueshëm zhvillimi në zonat rurale.

Shoqëria civile u vlerësua si iniciatore e ndryshimit në vendosjen e partneriteteve vendore me institucionet dhe biznesin vendor.

Ndërtimi i këtij vizioni u mbështet në mundësitë e vendit për një larmi prodhimesh tradicionale, të fermave familjare, nxitjen e agro-turizmit, agro-përpunimit, dhe vlerësimin e trazhëgimisë kulturore.

Pjesëmarrësit u dakortësuan se Zhvillimi Vendor i udhëhequr nga Komuniteti (CLLD) është kuadri ku aktorët vendorë mund të nxisin zhvillimin jo vetëm përmes prodhimit, mjedisit, kulturës, territorit, por edhe përmes burimeve njerëzore. Është në dorë të vendim-marrjes që t'i shfrytëzojë këto mundësi.

Sfida e Zhvillimit Vendor të Udhëhequr nga Komuniteti

Prioritetet e qeverisë shqiptare në katër-vjeçarin në vijim duhet të konsiderojnë zhvillimin rural si strategjinë themelore për të mundësuar, jo vetëm rritjen e nivelit të prodhimit dhe produktivitetit, por edhe diversifikimin e aktiviteteve lokale dhe rritjen e fuqisë së veprimit të aktorëve në nivel lokal.

Instrumentet e politikave publike në zonat rurale duhet të ndërtohen në dy drejtime: përmirësimi dhe intensifikimi i aktivitetit ekonomik si edhe ndërtimi i një strategjie specifike sociale dhe mjedisore për përmirësimin e nivelit të jetesës.

Zhvillimi Vendor i udhëhequr nga Komuniteti (CLLD), si një formë e re e zhvillimit të zonave rurale, urbane dhe sub-urbane si edhe ngritjes së LAG-eve, mundëson që komunitetet vendore të marrin rëndësi si iniciatorë të ndryshimit. Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të konsiderojë mbështetjen për këto politika rurale, si përmbushje të programeve të saj në ndihmë të reformës territoriale dhe rritjes së punësimit.

Anëtarët e parlamentit rural theksuan nevojën për marrjen e informacionit, nxitjen e inovacionit dhe aftësimin profesional për zhvillimin rural.

Kërkohet që sektori publik në nivel kombëtar të rrisë kapacitetet menaxheriale dhe operacionale të të gjithë sektorëve që merren me zhvillimin rural, si një politikë dhe qasje ndërsektoriale, duke prioritetizuar miratimin e praktikës rregullatore për zbatimin e LEADER. Bashkitë, që janë një nga partnerët shumë të rëndësishëm të LAG-eve, janë pothuajse të paeksponuara ndaj kësaj përvoje dhe kanë mungesa të ndjeshme kapacitetesh.

Në nivel rajonal, nën-rajonal dhe lokal, partneritetet ndër-sektoriale dhe ato publike e private duhet të luajnë një rol gjithmonë e më të madh për të bërë bashkë të gjitha segmentet e shoqërisë në këtë lëvizje për një zhvillim të qëndrueshëm. Përvoja e shumë vendeve europiane dëshmon se iniciatorët e ndryshimit në drejtim të qasjes LEADER qëndrojnë me shoqërinë civile, e cila duhet të vlerësohet si partnere e qenësishme e institucioneve qeverisëse vendore në këtë sipërmarrje.

Për shumë arsye, krijimi i LAG-ve nuk mund të konsiderohet si një proces që mund të ndodh vetvetiu. Ai është një proces relativisht i gjatë, gjithëpërfshirës dhe i konsultuar me komunitetet vendore. Ndërtimi i besimit midis partnerëve dhe komunitetit mbetet në themel të suksesit të kësaj sipërmarrje. Prandaj, çdo hezitim, nga ana e qeverisë, donatorëve, apo institucioneve për të krijuar një mjedis inkurajues dhe mbështetës në këtë drejtim rrit koston dhe nuk garanton mirëmenaxhimin e zhvillimit rural dhe mbështetjen financiare që pritet të akordohet në të ardhmen e afërt.

Rekomandime

Për Parlamentin:

- Të zgjerojë hapësirën e dialogut mes aktorëve dhe faktorëve të zhvillimit rural në Shqipëri.
- Parlamenti në përgjithësi, dhe Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në veçanti, të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2014-2020, ku përfshihen të gjithë sektorët përmes ministrive të linjës dhe të nxisë hartimin e politikave dhe strategjive të reja bazuar në evidenca, në bashkëpunim të ngushtë me botën akademike.
- Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të jetë më aktiv dhe më komunikues me Këshillin e Investimeve për krijimin e mundësive të përthithjes së kapitalit vendas dhe të huaj në të mirë të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve të zonave rurale.
- Parlamenti të shfrytëzojë mekanizmat institucionale për t'i dhënë zgjidhje problemeve që lidhen me pronësinë e tokës, regjistrimin e saj, si edhe nxitjen e tregut të tokës.

Për Qeverinë:

- Qeveria të vlerësojë zbatimin e suksesshëm të qasjes LEADER, si një mundësi tjetër në ndihmë të reformës territoriale për të integruar territorin urban, sub-urban dhe rural, dhe nxitur kështu përfshirjen e të gjithë aktorëve vendorë (përfshirë qytetarët) në praktikat bashkëkohore zhvilluese.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të evidentojë më qartazi rolin e saj si institucioni kryesor për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural 2014-2020 edhe në raport me ministrinë e linjës. E rëndësishme është që kjo qasje e integruar të përcillet në institucionet publike në nivel vendor për t'i orientuar drejt qasjes LEADER.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të prioritzojë krijimin e infrastrukturës rregullatore për zbatimin e LEADER. Kjo do të drejtohej dhe lehtësonte përpjekjet e aktorëve vendorë drejt formalizimit të partneriteteve publik-privat, konstituimin dhe zhvillimin e planeve zhvillimore të LAG-eve. Qeveria nëpërmjet programeve sektoriale dhe ndërsektoriale si dhe rolit koordinues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të rigjejë instrumentat e duhur që të mundësojë një klimë përkrahëse në fushën juridike, legjislative, administrative dhe financiare.
- Qeveria qendrore dhe lokale në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare të bashkëpunojnë për rritjen e gjithëpërfshirjes dhe ngritjen e sistemeve domethënëse për vendim-marrje bazuar në konsultime dhe bashkëpunim, me qëllim që t'u mundësojë palëve rurale të interesit të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare dhe lokale.
- Qeveria duhet të funksionalizojë Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile,
- Të inkurajohen politikat sociale gjithëpërfshirëse dhe të drejta për t'i ofruar një jetesë më të denjë grave, fëmijëve, të rinjve dhe burrave që jetojnë në zonat rurale.
- Qeveria duhet të forcojë arsimin e mesëm profesional bujqësor dhe rural,
- Të ndërmerren hapa të mëtejshëm për rritjen e aksesit në instrumenta apo shërbime financiare, këshillimi, dhe inpute bujqësore të kontrolluara.

Për Sektorin e Biznesit:

- Grupet e biznesit dhe akademia të krijojnë mundësi ndërveprimi për të nxitur inovacionin, përshtatjen me teknologjitë, lehtësimin e kërkesave për kapital dhe ngritjen e sistemeve të sigurimit ndaj riskut për të sjellë kështu mundësi më të mira për lindjen e bizneseve të reja.
- Qeveria dhe komuniteti i biznesit të ofrojnë zgjidhje të ndryshme të Partneritetit Publik Privat, të cilat do sillnin jo vetëm një përmirësim të shërbimeve dhe tregjeve rurale, por do të diversifikonin ekonominë rurale, si dhe t'u mundësojnë të rinjve dhe grave të qëndrojnë ose të kthehen në zonat rurale.
- Komuniteti i biznesit të rrisë komunikimin me palë të tjera të interesit, sidomos me qeverisjen lokale, për të ngritur një mjedis më të mirë taksor, një sistem më të përmirësuar transporti dhe një shtrirje më të gjerë të prezencës së shërbimeve private, duke u kthyer kështu në një formë komunikimi midis zonave urbane dhe rurale dhe një reduktues të pabarazive e barrierave që ekzistojnë midis tyre.

Për Shoqërinë Civile:

- Shoqëria civile të intensifikojë përpjekjet për një mjedis mundësues për forcimin e saj përmes një advokacie kombëtare.

- Shoqëria civile të rrisë mirëqeverisjen e saj si faktor i rëndësishëm për të marrë me sukses rolin e saj të iniciatorit të ndryshimit.
- Të promovohen praktika të mira të shoqërisë civile që kanë në fokus zhvillimin e gjallërimin e zonave suburbane dhe rurale. Qoftë edhe iniciativa të izoluara mbarin mundësinë për t'u shndërruar në LAG-e.

Për Akademinë:

- Akademia dhe kërkimi shkencor duhet të kenë një qasje më të madhe në hartimin dhe konsolidimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural si edhe në monitorimin dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe lehtësisht të zbatueshme ndaj sfidave rurale.
- Të realizohet një lidhje më funksionale midis institucioneve kërkimore dhe politikëbërjes dhe vendimmarrjes në nivel kombëtar dhe vendor në ndihmë të një agjende që zgjidh dhe lehtëson problemet konkrete në zonat rurale.
- Të promovohen programe edukimi që rrisin jo vetëm profesionalizmin në zonat rurale, por sjellin ngritje të kapaciteteve, burime dhe përkrahje për të nxitur një qeverisje lokale që inkurajon lidhshmëri novator, të qëndrueshëm dhe llogaridhënës.
- Programet akademike të nxiten të rifreskojnë aftësitë e nevojshme profesionale në zonat rurale, si dhe të sigurojnë qasje efektive në shërbimet arsimore, përfshirë dhe mjetet inovatore si mësimin në distancë dhe trajnimin profesional të përshtatur sipas nevojave të jetesës në zonat rurale.